



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ekonometria Financiare
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I (Sems. II)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Ky kurs do të paraqesë një trajtim të avancuar të parimeve ekonometrike për grupet e të dhënave ekonometrike financiare në seksionet e kryqëzuara, panele dhe të serive kohore. Duke u përqendruar në modelet lineare, do të diskutohen gjithashtu disa raste jolineare, veçanërisht modele të kufizuara të variablave të varura dhe metoda të përgjithësuara të momenteve. Kursi do të fokusohet në teknikat moderne ekonometrike, duke trajtuar si derivimet teknike ashtu edhe aplikimet praktike. Shembujt e aplikimit që do të merren parasysh janë nga fushat e financave, tregjeve financiare, ekonomisë financiare, menaxhimit financiar, financave të korporatës, investimeve, mikroekonomisë, makroekonomisë etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të jenë të aftë të bëjnë parashikime financiare duke aplikuar modele ekonometrike dhe të jenë në gjendje të shkruajnë raporte financiare në interpretim të të dhënave të bizneseve dhe bankave.
Rezultatet e pritura:	Njohuri (NJ): *NJ1. Studentët do të zotërojnë njohuri të avancuara mbi konceptet dhe modelet kryesore ekonometrike të aplikuara në fushën e financave dhe do të demonstrojnë aftësi për të zbatuar këto njohuri në kontekste financiare të ndryshme. *NJ2. Studentët do të jenë në gjendje të shpjegojnë parimet dhe teknikat e analizës së të dhënave financiare duke përdorur modelet ekonometrike për të mbështetur vendimmarrjen strategjike në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe financave.

	Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1. Studentët do të zhvillojnë dhe vlerësojnë modele ekonometrike të avancuara për të analizuar dhe interpretuar të dhënat financiare dhe për të nxjerrë përfundime të besueshme mbi performancën e subjekteve financiare, si për bankat ashtu dhe për bizneset. **A-K2. Studentët do të jenë të aftë të përzgjedhin modelin ekonomik më të përshtatshëm për situata specifike financiare, duke vlerësuar efikasitetin dhe përshtatshmërinë e tij në analizën financiare. **A-K3. Studentët do të aplikojnë teknika të testimit të hipotezave në kontekste financiare për të verifikuar teoritë dhe për të mbështetur analizat financiare. **A-K4. Studentët do të përdorin modele ekonometrike për të kryer parashikime ekonomike dhe financiare, duke përgatitur prognoza mbi indikatorët kryesorë të performancës së bizneseve dhe sektorëve financiarë. **A-K5. Studentët do të zhvillojnë aftësi për të përpiluar dhe prezantuar raporte të strukturuar të analizave dhe rezultateve financiare bazuar në teknika ekonometrike, duke përfshirë rekomandime për vendimmarrjen e bazuar në të dhëna. Aftësi (A): ***A1. Studentët do të përvetësojnë aftësinë për të prezantuar analiza financiare komplekse në mënyrë të qartë, argumentuese dhe bindëse për audienca të ndryshme profesionale. ***A2. Studentët do të zhvillojnë aftësi për të bashkëpunuar në projekte kërkimore dhe analitike të grupit dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në punë ekipore që kërkojnë analiza të avancuara ekonometrike dhe financiare. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	4	5	15
Kollokfume, seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	5	10
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Totali			150

Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.

Përshtatja e ECTS me orët totale: $150 \text{ orë} \div 25 = 6 \text{ ECTS kredi}$.

Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mesimore në Power Point • Perseritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Përdorimi i softuerit STATA • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjeruar
Metodat e vlerësimit:	• Projekti i parë vlerësohet: 0 - 20% • Testi vlerësohet: 0 - 30% • Provimi përfundimtar: Punimi dhe prezantimi: 0 - 50%
Literatura	
Literatura bazë:	• Ligjerata të përgatitura nga profesori i lëndës në fushën e ekonometrisë financiare. • Cheng-Few Lee, Hong-Yi Chen, John Lee (2019) • Financial Econometrics, Mathematics and Statistics (Theory, Method and Application) - Springer, Center for PBBER Research, USA. • Panchanan Das (2019) - Econometrics in Theory and Practice Analysis of Cross Section, Time Series and Panel Data with Stata, Springer, ISBN 978-981-32-9018-1

Literatura shtesë:	• Christopher F. Baum (2009) - An Introduction to Stata Programming, A Stata Press Publication, Stata Corp LP, College Station, Texas. ISBN-10: 1-59718-045-9. • Kyle C. Longest (2015) - Using Stata for Quantitative Analysis, Second Edition, SAGE, ISBN 978-1-4833-5663-1
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në Ekonometrinë Financiare
Java e dytë:	Bazat Statistike
Java e tretë:	Modelet e Regresionit Linear 1
Java e katërt:	Modelet e Regresionit Linear 2
Java pestë:	Analiza e Serive Kohore
Java gjashtë:	Testi i pare vleresues
Java e Shtatë:	Modelet e Serive Kohore Multivariate
Java e tetë:	Modelimi i Volatilitetit 1
Java e nëntë:	Modelimi i Volatilitetit 2
Java e dhjetë:	Modelet e të Dhënave Panel 1
Java e njëmbëdhjetë:	Modelet e të Dhënave Panel 2
Java e dymbëdhjetë:	Menaxhimi i Riskut dhe Vlera në Risk (VaR)
Java e trembëdhjetë:	Parashikimi në Tregjet Financiare
Java e katërmëdhjetë:	Testi i dyte vleresues
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i punimeve hulumtuese

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutim e lidhur me to. Student i duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë

hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe të punimit.